



SHERBIMI SOCIAL

#GATI PËR TË PLOTËSUAR NEVOJAT E TË GJITHË QYTETARËVE NË NEVOJË



Zonja Dh. M nga qyteti i Fierit prej vitesh qëndron në një karrocë me rrota, e cila tashmë është e vjetëruar. Familjarët e zonjës i'u drejtuan Shërbimit Social Shtetëror për ndihmë.

Menjëherë pas kërkesës së marrë, Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror duke u koordinuar me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Fier, i mundësuan zonjës një karrocë tërësisht të re dhe të përshtatur për të.

#PANAIRI I AFTËSIVE



Në Qendrën Rinore të Tiranës është mbajtur për herë të parë panairi i punimeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Gjashtë qendra të zhvillimit në të gjithë Shqipërinë kanë prezantuar punimet e fëmijëve në pikturë, skulpturë dhe punime të ndryshme dore.

Fëmijët në qendrat e zhvillimit marrin çdo ditë përkujdes dhe shërbime terapeutike me qëllimin e vetëm të sigurimit të pavarësisë dhe rikthimit pranë familjes.




SHERBIMI SOCIAL

#DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESAVE TË NE DHE PAK

Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK ka kryer kontroll në Njësinë Administrative Libofshë, Qarku Fier lidhur me zbatimin e legjislacionit për Ndihmën Ekonomike dhe metodologjinë e re të kontrollit për periudhën Janar-Dhjetor 2018.

Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK ka monitoruar kontrollet e kryera nga Drejtoritë Rajonale sipas planifikimit të bërë për muajin. Është përgatitur raporti i vlerësimit të situatës së skemës së NE dhe janë nxjerrë raporte të veçanta për secilin qark.



#DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Gjatë muajit Mars, Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka kryer 28 vlerësime social-ekonomike të fëmijëve të pashoqëruar si edhe janë riatdhesuar 12 fëmijë të pashoqëruar. Janë menaxhuar 5 raste VT/VMT dhe viktima të dhunës në familje.

Gjatë muajit mars është mbledhur komisioni për fëmijët dhe janë sistemuar në institucione 11 fëmijë. Është kryer transferimi i 3 fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe është pranuar 1 PAK në një OJF.

Janë rinovuar 33 librezat të statusit të jetimit.





SHERBIMI SOCIAL

#INSTITUCIONET E PËRKUJDESIT SHOQËROR



Erdhi Hirushja te Shtëpia e Foshnjës “Hannah dhe Rozafa”

Fëmijët e Shtëpisë së Foshnjës “Hannah dhe Rozafa” kanë kaluar një ditë të mrekullueshme nën shoqërinë e stafit të CFO Farma dhe animatorëve socialë. Ky aktivitet u mbështet nga CFO Farma, të cilët prej kohësh janë miq të fëmijëve të familjes sonë të madhe. CFO Farma, përveç dëshirës për t’i dhuruar fëmijëve një ditë ndryshe, kanë kontribuar gjithashtu me produkte të ndryshme farmaceutike për fëmijë.